



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.07.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.07.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Integral SHPK" për aktivitetin: "Ndertimi i infrastrukturës rrugore në lagjet Perroi i Njelmet, Taslixhe, Qendresa, Kolevice, Emshir dhe Mati 1" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1017-511-lot 2 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Integral SHPK" e datës 24.07.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit <"Ndertimi i infrastrukturës rrugore në lagjet Perroi i Njelmet, Taslixhe, Qendresa, Kolevice, Emshir dhe Mati 1", me nr.616 19 1017 511 kundër Ndryshimit të Njoftimit të Vendimit për dhënje të kontratës të AK –së, të datës 23.07.2019, të publikuar në Platformën elektronike E Prokurimi të KRPP-së.

1. **VERTETOHET Njoftimi i ndryshuar i Vendimit për dhënje të kontratës** i publikuar me datë: 23.07.2019;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Integral SHPK**" me datë 24.07.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: < Ndertimi i infrastrukturës rrugore në lagjet Perroi i Njelmet, Taslixhe, Qendresa, Kolevice, Emshir dhe Mati 1"> me Nr.616 19 1017 511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 26.07.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar drejt me rastin e ndryshimit të Njoftimit për kontratë të datës 23.07.2019, kur ka ndryshuar propozimin për dhënje të

kontrates per pjesen e dyte:Ndertimi i infrastruktures rrugore ne lagjen Taslixhe eshte i pabazuar per arsyet qe do te paarqiten en vazhdim.

Autoriteti Kontraktues lidhur me kete ju sqaron si vijon:

- Se pari eshte gabimi juaj administrativ qe gjate dorezimit te tenderit tuaj ne Platformen elektronike eshte percjellur çmimi i gaabuar ne lidhje me lotin 2 te tenderit duke paraqitur ne formular nje çmim tjeter ne krahasim me çmimin nga paramasa;
- Komisioni i veresimit eshte bazuar ne çmimin e dhene ne formularin e tenderit e qe do te duhej te ishte i njejte me çmimin nga paramasa dhe parallogaria;
- Publikimi i Njoftimit per Vendimin e Autoritetit Kontraktues eshte bere me date 08.07.2019 dhe ju nuk keni ngritur asnje shqetesim e as qe keni derguar ndonje informim lidhur me ngaterrimet qe kane te bejne me çmimet e lotit per te cilin jeni propozuar per dhenje te kontrates dhe i cili do te ndihmonte qe komisioni te shqyrtonte mundesine e pranimit apo mospranimit te gabimeve te paraqitura.Informimin apo shqetesimin tuaj e keni paraqitur pas publikimit te Njoftimit per dhenje te kontrates e qe i bie se kjo sipas jush eshte dashte te paraqitet ne situaten kur ndryshimi i te propozuarit eer dhenje te kontrates paraqet problem teknik,por duke mos marre parasysh se ndryshimi qe eshte paraqitur paraqet nje devijim me te madh nga ai qe e lejojne dipsozitat ligjore;
- Me daten 22.07.2019 neper mes adreses elektronike jeni informuar se nese nuk vini te nenshkruani kontraten Autoriteti Kontraktues do te konsideroj se ju keni hequr dore nga kjo kontrate.Mos deklarimi juaj lidhur me kete ka qene arsyeja qe Autoriteti Kontraktues eshte detyruar te ndryshoj Vendimin e vet per lotin 2. Pretendimet lidhur me bisedat telefonike nuk mund te jene teme e kerkesave per rishqyrtim apo Vendimeve sipas te njejtave,pasiqe çdo komunikim duhet te behet me mjete elektronike. Poashtu arsyetimet se shkresat i keni verejtuar me vonese jane te pa bazuara,pasiqe eshte obligimi i juaji perkujdesja per te njejtat.

Pra nga kjo mund te konstatohet se ju jo vetem qe keni bere gabime ne dorezimin e çmimeve te tenderit,por nuk e keni informuar me te njejtat asnjehere Autoritetin Kontraktues deri ne kohen e nenshkrimit te kontrates,kur realisht keni kontestuar çmimin e te njejtes.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pretenduesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

Vendimi u dërgohet:

- Palës ankuese(nepermes Platformes elektronike;
- Njesisë së kërkesës;
- Departamentit të Prokurimit;dhe
- Anëtarëve të komisionit